



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 640 Prot.

Patos, më 13 / 02 / 2026



**MIRATOHET
KRYETARI
Faton Duro**

PROJEKTVENDIM

Nr. 10, datë 13/02 / 2026

MBI MIRATIMIN E OBJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SALIAJ, GRIZË LËNGINAS”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2026”,

I KËRKOJMË KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS:

- Të miratojë objektin “Rehabilitimi i rrugës “Saliaj”, Grizë-Lënginas” me vlerë projekti 8,000,000 (tetë milion) lekë.
- Financimi i këtij objekti do të mbulohet midis zërave buxhetor të investimeve në programin “Zhvillimi Ekonomik dhe Rural” për vitin 2026-2027.

Për ndjekjen dhe zbatimin ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile dhe Njësia e Prokurimit.

Drejtuesi i Programit

Zhvillimi Ekonomik dhe Rural

Çajup Refitaj

Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari

Zv/Kryetar

Ina Sauli

Dr. Zhvillimi i Territorit dhe EC

Boreta Murati

Juristi

Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 641 Prot.

Patos, më 13 02 /2026

RELACION

MBI MIRATIMIN E OBJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS SALIAJ, GRIZË LËNGINAS"

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhmin Financiar dhe Kontrollin", kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", VKB nr. 82, datë 17/12/2025 "Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026",

Në zbatim të planit buxhetor afatmesëm dhe prioriteteve të Bashkisë Patos për vitin 2026 është parashikuar rehabilitimi i segmentit "Saliaj" në fshatin Grizë Lënginas

Ky investim vjen si rezultat i kërkesave të vazhdueshme të banorëve të zonës, si dhe për shkak të gjendjes së amortizuar të këtij segmenti rrugor, i cili paraqet dëmtime në shtresat sipërfaqësore për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ndër vite, mungesa e kanalit kullues për ujërat e bardha, dëmtimet e urave të kalimit në hyrjet e banesave.

Rehabilitimin e rrugës "Saliaj" përfshin sistemimin e shtresave asfaltike, disiplinimi i ujërave të bardha duke krijuar një rrjet kullues me kanal betoni në njërën anë të rrugës. Ndërtimi i bankinave me stabilizant dhe krijimi i urave të kalimit në hyrjet dhe daljet e banesave. Ky investim synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rritjen e sigurisë gjatë lëvizjes dhe lehtësimin e aksesit të banorëve të zonës.

Vlera e parashikuar për realizimin e këtij objekti është 8,000,000 lekë. Financimi i këtij objekti do të mbulohet midis zërave buxhetor të investimeve në programin "Zhvillimi Ekonomik dhe Rural" për vitin 2026-2027.

I KËRKOJMË KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS:

- Të miratojë objektin me emërtim "Rehabilitimi i rrugës "Saliaj" Grizë-Lënginas" me në vlerën 8,000,000 (tetë milion) lekë me tvsh.

Për ndjekjen dhe zbatimin ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile dhe Njësia e Prokurimit.

Drejtuesi i Programit

Zhvillimi Ekonomik dhe Rural

Çajup Refitaj



Dr. Zhvillimi i Territorit dhe E.C

Boreta Murati




Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari



Juristi

Joana Sherifi



ZV/KRYETAR

Ina Sauli

